

Policia del me detaje për shkëmbimin me armë zjarri dje në veri

LAJME



31/12/2023 08:44



Policia në raportin e saj ditor njofton se gjatë patrullimit në veri dje, ka hasur në dis automjete.

Dhe në përpjekjet e tyre për ti ndaluar, janë detyruar të përdorin edhe armët, shkruan lajmi.net.

Njëri nga ta është arrestuar, ndërsa të tjerët kanë ikur duke braktisur automjetet e tyre.

Në automjetin e të arrestuarit janë gjetur 40 dele, ato janë dërguar në terminalin doganor.

Njoftimi i policisë:

Bube, Zubin Potok / 30.12.2023 – 06:15. Policia gjatë patrullimit kanë vërejtur disa automjete të dyshuar duke lëvizur dhe në përpjekje për ti ndaluar kanë hasur në rezistencë të armatosur nga personat e dyshuara me ç'rast policia në vetëmbrojtje janë obliguar të përdorin armët zyrtare duke bërë të mundur arrestimin e njërit prej tyre të dyshuarin mashkull kosovar/s, ku gjatë kontrollit në kamion i janë gjetur 40 dele pa dokumente përcjellëse, ndërsa janë konfiskuar dy automjete tjera të cilat të dyshuarit tjerë i kanë braktisur dhe janë larguar në drejtim të panjohur. Përveç dëmeve të shkaktuara në automjetin e policisë nuk raportohet për lëndime në njerëz. Me vendim të prokurorit delet me kamion janë dërguar në terminalin doganor, ndërsa i dyshuari është dërguar në mbajtje./Lajmi.net

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia




Artikuj të ngjashëm



December 31, 2023

Mjegulla: Policia apelon për kujdes gjatë vozitjes



December 31, 2023

Kanosen e malltreshen dy gra: Një në Lipjan dhe tjetra në Podujevë



December 31, 2023

Puna e Qeverisë gjatë 2023: Opozita me kritika të shumta



December 31, 2023

Nga 1 janari 2024 Belgjika nis kryesimin e BE-së: Skepticismi rreth...



December 31, 2023

Moti për ditën e sotme



December 30, 2023

Zelensky nderon Ramën: E dekoron me çmim shtetëror

